AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-177/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores Nr. 06/2020 për angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 09 Mars 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Miratohet plotësim ndryshimi i nenit 5.1 i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë, për financimin e Ofruesve të Shërbimeve për nevojat e administratës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës;

II. Autorizohet Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve për nënshkrimin e amandamentimit të Memorandumit të Mirëkuptimit;

III. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për plotësim ndryshim të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë, për financimin e Ofruesve të Shërbimeve për nevojat e administratës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Me qëllim të përshpejtimit të proceseve të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe në përgjithësi ndihmës së ndërsjellë në mes të AKP dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 12 Korrik 2022 është nënshkruar Memorandumi i mirëkuptimit për angazhimin e dhjetë (10) Ofruesve të Shërbimeve/Juristë të diplomuar.

Për shkak që aktualisht në Dhomën e Posaçme janë në proces të punës rreth 17,000 lëndë, më datë 20 janar 2023 KGJK ka dërguar kërkesë për shtimin e numrit të OSh-ve edhe për dhjetë (10) pozita në mënyrë që të rritet dinamika e punës së tyre.

Menaxhmenti ka rekomanduar Bordit të Drejtorëve të AKP-së që të aprovoj plotësim/ndryshimin e nenit 5.1 të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë, për financimin e shtatë (7) Ofruesve të Shërbimeve për nevojat e administratës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, pra për shtimin e numrit të Osh-ve nga dhjetë (10) sa janë aktualisht në shtatëmbëdhjetë (17) OSh.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 09 Mars 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-177/2

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit të AKP-në, nenit 10, paragrafi 1.5 dhe neni 10, paragrafi 1.3 i Rregullores me nr. 04/2022 e datës 31 gusht 2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të e mbajtur me datën 09 Mars 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 187.9 m² të hapësirës afariste në katin e gjashtë (6), të ndërtesës administrative nr. dy (2), e ndërtuar mbi parcelat nr. 1413 dhe 1416 Zona Kadastrale Mitrovicë e Jugut në pronësi të NSh "Jugobanka" MIT101, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 410.00 për një muaj.

II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësi është i detyruar të paguajë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, shumën prej € 1,230.00 për periudhën e shfrytëzimit dhjetor 2022 – shkurt 2023 të hapësirës në mënyrë të pa autorizuar.

III. Hyrja në marrëdhënien kontraktuale të qirasë me OJQ "7 Arte" nuk duhet të konsiderohet si tërheqje nga padia e parashtruar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me C.nr. 418/2013 ndaj të paditurëve, në mesin e të cilëve është edhe OJQ "7 Arte". Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit – AKP do të qëndrojë mbrapa pretendimeve të paraqitura në padi dhe do të kërkojë kompensimin për periudhën 21.03.2011 deri më 30.11.2022, periudhë e shfrytëzimit në mënyrë të paligjshme në bazë të vendimit të Kryetarit të KK Mitrovicë nr. nr. 01/88.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit dhe Autoriteit të Likuidimit lidhur me aprovimin e kërkesës për qira direkte të OJQ 7 Arte për asetin e NSH Jugobanka në Mitrovicë.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me shfrytëzuesin do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Kësisoj qiradhënia e këtij aseti është e arsyeshme pasi që do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij.

Pasi që pala ka parashtruar kërkesë që të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë dhe aktualisht i njëjti është shfrytëzues i kësaj parcele, është formuar komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut dhe kësisoj më datë 26 janar 2023 është përgatitur Raporti i vlerësimit të çmimit të tregut të qirasë për qiradhënien e hapësirës afariste në katin e gjashtë (6), të ndërtesës administrative nr. dy (2), e ndërtuar mbi parcelat nr. 1413 dhe 1416 Zona Kadastrale Mitrovicë e Jugut me sipërfaqe prej 187.9 m² dhe në bazë të këtij raporti është përcaktuar çmimi në shumën € 410.00 (bruto)/muaj.

Pala është duke e shfrytëzuar pjesën e hapësirës afariste në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës dhe për periudhën e shfrytëzimit nga nxjerra e vendimit në fjalë, është e inicuar padia dhe kërkohet kompensimi i dëmit për shfrytëzimin e paligjshëm edhe të kësaj hapësire afariste nga OJQ "7 Arte" dhe Autoriteti i Likuidimit do të mbetet pranë kërkesës për kompensim të dëmit nga OJQ "7 Arte" për tërë periudhën e shfrytëzimit deri më 31 nëntor 2022. Duke pasur parasysh që kërkesa për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë është parashtruar më datë 29 dhjetor 2022, atëherë muaji dhjetor 2022 do të i llogaritet retroaktivisht për

pagesë në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, pala do të jetë e obliguar që para nënshkrimit të kontratës së qirasë të paguajë retroaktivisht për periudhën e shfrytëzimit prej 3 muajsh (dhjetor 2022 – shkurt 2023) në shumën totale prej 1,230.00 Euro (410.00 €/muaj).

Hyrja në marrëdhënie kontraktuale të qirasë, nuk mund të konsiderohet dhe as të paragjykohet si tërheqje e padisë ndaj të paditurit OJQ "7 Arte" në lëndën C.nr. 418/2013 dhe as si falje e borxhit në emër të kompensimit të dëmit për periudhën e shfytëzimit, nga data 21.03.2011 (dt. kur u lëshua vendimi nr. 01/88 nga ana e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës për shfrytëzimin e kësaj hapësire) e deri në datën 30.11.2022 (sepse nga dhjetori 2022 llogaritet pagesa retroaktive për hyrje në marrëdhënien kontraktuale të qirasë, duke e marrë për bazë kohën e paraqitjes së kërkesës nga ana e parashtruesit – OJQ "7 Arte".

Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 09 Mars 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-177/3

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit të AKP-në, neni 10, paragrafi 1.3 i Rregullores me nr. 04/2022 e datës 31 gusht 2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 09 Mars 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte sipas kërkesës së OJQ Integra së bashku me Casa të hapësirës afariste në Lamelën A, Kati i Katërt në Grand Hotel me sipërfaqe prej 395 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 2,330.00 për një muaj, në pronësi të NSh "NewCo Grand Hotel" PRN173.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit dhe Autoriteit të Likuidimit lidhur me aprovimin e kërkesës për qira direkte të sipas kërkesës së OJQ Integra së bashku me Casa për asetin e NSh "NewCo Grand Hotel" PRN173.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me palën do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Sipas matjeve të realizuara rezulton se hapësira afariste ka sipërfaqe prej 395 m^2. Qiradhënia e kësaj zyre afariste është e arsyeshme pasi që do të lehtësonte ushtrimin e veprimtarisë së kësaj organizate në raport projektet në aspektin kulturor dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij.

Pasi që OJQ Integra së bashku me Casa ka parashtruar kërkesë që të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë, është formuar komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut dhe kësisoj më datë 24 janar 2023 është përgatitur Raporti i vlerësimit të çmimit të tregut të qirasë për qiradhënien e hapësirës afariste që ndodhet në lamelën A, kati i katërt me sipërfaqe 395 m^2.

Kësisoj është përcaktuar edhe çmimi i qirasë për secilën zyre, ashtu që çmimi i qirasë për hapësirën afariste është € 2,330.00/muaj (€ 5.90/m^2).

Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 09 Mars 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit